

Nëse keni MDR TB dhe doni të mësoni më shumë rreth tij nga dikush që e ka kaluar këtë sëmundje, ekziston një libër i titulluar "The Tuberculosis Survival" (Manuali i mbijetesës nga tuberkulozi) nga Paul Mayho (botimi i dytë). Libri kushton 14,95 GBP dhe gjendet në libraritë lokale, te kompania Gazelle e shërbimeve të shpërndarjes së librit dhe te www.amazon.co.uk, ose drejtpërdrejt nga botuesit, në faqen e internetit www.meritpublishing.com të kompanisë Merit Publishing International ose duke dërguar një e-mail në adresën merituk@aol.com. Numri i referencës për të porositur librin është ISBN 1 873413 14 9.

Shënime:

Mbroni të gjithë familjen dhe miqtë nga TB - merrni ilaçet e TB-së

Mos harroni se Infermierja e tuberkulozit është këtu për t'ju ndihmuar dhe për t'ju këshilluar gjatë të gjithë trajtimit tuaj. Ju lutemi kontaktoni infermieren tuaj të tuberkulozit nëse nuk ndiheni mirë gjatë trajtimit tuaj ose nëse ka ndonjë gjë që jeni të pasigurt për mjekimin tuaj.

Infermierja juaj e tuberkulozit është:

Doktori juaj në spital është:

Nr. i kontaktit:

E-maili:

TB Alert është një vepër unike bamirësie, që rrit ndërgjegjshmërinë për Tuberkulozin në Mbretërinë e Bashkuar dhe që po mbështet punën e NHS-së, duke ofruar informacione për pacientët. Ne mbështesim projektet në vendet që janë në zhvillim duke siguruar që të gjithë pacientët të marrin trajtimin e duhur. Me mbështetjen tuaj, ne mund të arrijmë një ndikim shumë të madh pozitiv, në mbarë botën për tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.



TB Alert,
Community Base,
113 Queens Road,
Brighton BN1 3XG
Tel: 01273 234030

Për informacione të mëtejshme ose për kopje të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni 01273 234 770 (vetëm në orarin zyrtar).

Për të bërë një donacion ose për të dalë vullnetar për të ndihmuar **TB Alert**, ju lutemi kontaktoni 01273 234 784 (vetëm në orarin zyrtar).

Ose vizitoni faqen tonë të internetit në www.tbalert.org

Informacioni i dhënë në këtë broshurë rreth tuberkulozit rezistues ndaj shumë ilaçeve ka si synim të japë informacion të përgjithshëm rreth subjektit. Ai nuk mendohet të zëvendësojë njohuritë, ekspertizën, aftësitë dhe gjykimin e infermieres/doktorit tuaj të tuberkulozit ose të profesionistëve të tjerë të shëndetësisë. Asnjë nga informacionet që përmban kjo broshurë nuk mendohet të përdoret për të marrë vendime për diagnoza ose për kurim. Pyetjet dhe problemet në lidhje me diagnozën dhe kurimin duhet t'i drejtohen një profesionisti të kujdesit shëndetësor.

Punim origjinal kërkimor nga North West London TB Network



Tuberkulozi rezistent ndaj shumë ilaçeve (MDR TB)

je e madhe gjatë natës
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë
Gjendra të ënjtura Gjendra të
Temperaturë!! Humbje e pashpjegueshme në
Temperaturë!! Djersitje e madhe gjatë natës
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë

Çfarë është tuberkulozi?

Tuberkulozi (TB) është një infeksion bakterial që kryesisht gjendet në mushkëri, por që mund të ndikojë çdo pjesë të trupit, si trurin, gjëndrat limfatike, veshkat dhe kockat.

Si merret tuberkulozi?

Kur dikush me tuberkuloz infektues të mushkërive kollitet, mikrobet mund të kalojnë në ajër në formën e piklave të vogla dhe njerëzit e tjerë mund t'i marrin me anë të frymëmarrjes. Personat që kanë më shumë gjasa të infektohen me tuberkuloz, janë ata që jetojnë në të njëjtën shtëpi ose apartament me personin e infektuar me tuberkuloz.

A jam infektues?

Jo të gjithë personat me tuberkuloz janë infektues. Ju jeni infektues vetëm nëse keni TB në mushkëri ose në fyt dhe ju kolliteni duke lëshuar mikrobe të TB-së (kjo quhet ndotje pozitive). Ju nuk jeni infektues për të tjerët nëse keni tuberkuloz në ndonjë pjesë tjetër të trupit tuaj, përveç mushkërive dhe fytyrës. Mjeku/infermierja juaj mund t'ju japë më shumë informacion.

Çfarë është tuberkulozi rezistent ndaj shumë ilaçeve?

MDR TB zhvillohet kur mikrobet e TB-së bëhen rezistentë ndaj ilaçeve më të fuqishme që përdoren normalisht për të trajtuar TB-në. Kjo do të thotë që këto ilaçe nuk do të funksionojnë me efekt përderisa nuk mund t'i vrasin më bakteret e tuberkulozit.

Kur dyshoni që dikush ka MDR TB?

Mostrat të cilat përmbajnë mikrobet e TB-së mund të testohen në laborator për të parë nëse ato mund të vriten nga ilaçe të ndryshme. Nëse ato nuk vriten, ka të ngjarë që pacienti të mos përmirësohet nga ilaçet e zakonshme të TB-së dhe kjo mund të presupozojë MDR TB-në.

Pse e marrin njerëzit MDR-në e tuberkulozit?

1. TB-ja mund të bëhet rezistent gjatë trajtimit, nëse trajtimi i marrë ka qenë i pamjaftueshëm për ndonjë arsye, p.sh:
 - Nëse pacienti nuk i ka marrë ilaçet rregullisht siç këshillohet ose nuk përfundon një cikël të plotë trajtimi.
 - Nëse pacienti nuk i thith plotësisht ilaçet, p.sh. si rezultat i të vjellave.
 - Nëse ilaçet nuk janë dhënë ose nuk janë marrë saktësisht.
 - Nëse ilaçet janë të cilësisë së dobët.
2. TB-ja mund të jetë rezistent që nga fillimi, sepse personi nga është marrë infeksioni ka pasur TB rezistent ndaj ilaçeve.

MDR TB-ja nuk është më infektues sesa TB-ja e zakonshme, por ilaçet që përdoren kundër tij kanë më pak efekt dhe duhet të përdoren për një kohë më të gjatë. Një person me MDR TB, është si rrjedhojë infektues për një kohë më të gjatë sesa një person me TB të cili është i ndjeshëm ndaj ilaçeve të zakonshme (TB i ndjeshëm ndaj ilaçeve).

Pse është problem MDR TB-ja?

MDR TB-ja nuk është më infektues sesa TB-ja e ndjeshme ndaj ilaçeve, por është më i vështirë për t'u trajtuar.

Ilaçet që përdoren për trajtimin e TB-së rezistent ndaj ilaçeve kanë më shumë efekte anësore dhe janë më pak efikase sesa ilaçet që përdoren për trajtimin e TB-së së ndjeshëm ndaj ilaçeve. Kjo do të thotë që pacientët me MDR TB kanë nevojë për trajtim për një kohë më të gjatë dhe mund të mos ndihen mirë për një kohë më të gjatë. Gjithashtu ka të ngjarë që të dërgohen në spital për trajtim.

Për sa kohë do të jem infektues?

Varet sesi reagoni ndaj ilaçeve me të cilët trajtoheni dhe çdo rast i MDR TB-së është i ndryshëm.

Për arsye se TB-ja është rezistent ndaj ilaçeve të ndryshme, ju mund të jeni infektues për disa javë ose ndoshta dhe muaj.

Për sa kohë duhet të marr trajtim?

Cikli i mjekimeve të TB-së së ndjeshëm ndaj ilaçeve zgjat të paktën 6 muaj. Trajtimi i MDR TB-së mund të zgjasë 18 muaj ose më shumë.